



**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT
NË MJEDIS**

EMËRTIMI I PROJEKTIT:

**MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE
INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI.**

VENDODHJA:

**QARKU ELBASAN, BASHKIA ELBASAN, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHIRGJAN,
MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T,
PRANË LUMIT SHKUMBIN.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Industria minerare, pika 3.1.e "Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos"; Menaxhimi i mbetjeve, pika 5.4.c. "Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme" dhe pika 5.10.b. "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Kërkues:

Subjekti "BLERIMI" Shpk

NIPT: J62903384G

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:

"GREEN Solution"

Laert Shehu

Administrator

Punoi raportin:

Ing. Laert Shehu

Ing. Vanina Latifi



Qershor, 2020

TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....	2
2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.	10
3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.	17
4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.	25
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....	25
6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....	25
7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	26
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	26
9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).	27

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti “Magazinim dhe rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme (mbetjeve inerte) dhe prodhimi i produkteve prej betoni” ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Elbasan, Njesia Administrative Shirgjan, Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan – Cerrik Km 4-t, prane lumit Shkumbin. Relievi i vendit te instalimit eshte i sheshte. Persa i perkete bimesise qe gjendet ne pronen ku zhvillohet aktiviteti eshte kryesisht e llojit peme frutore dhe agrume, te tilla si: fiq (4 fidane), agrume (3 fidane), sheqe (2 fidane), ftonj (2 fidane). Kjo bimesi eshte e mbjelle nga vete pronari dhe eshte bimesi e moshes rreth 5 vjecare. Ndersa perreth kufirit te prones, si dhe pergjate shtratit te kanalit kullues qe ndodhet ne afersi te prones, gjendet bimesi e llojeve te ndryshme te tilla si: akacie, plep i bardhe, arre, lajthi, sheqe, shelg i bardhe, etj. Siperfaqja qe eshte zene nga objekti nuk ben pjese ne siperfaqet pyjore te rajonit dhe nuk ka demtuar bimesine pyjore.

Foto te bimesise se rajonit dhe prones per zhvillim





Biodiversiteti dhe habitatet (te pergjithshme)

Biodiversiteti

Shqipëria vleresohet për një larmi të madhe biologjike dhe peizazhore. Origjina të kësaj llojshmërie, është e lidhur me: pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Larmia e madhe e ekosistemeve dhe habitateteve (ekosistemeve detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta mesdhetare, pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzjerë, livadhe dhe kullota subalpine e alpine, ekosisteme të maleve të lartë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore dhe shtazore duke përfaqësuar rreth 30% të florës Europiane. Ne percaktimin ligjor kemi kete percaktim: "Biodiversitet (shumllojshmeria biologjik) ose larmi biologjike" është tërësia e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Vizioni ynë për biodiversitetin është: të sigurohet zhvillim normal i flores dhe faunes ne vendjetesat e tyre, që keto peizazhe jo vetem te zbkurojne natyren por dhe të kontribuojë në rritjen në begatinë e vendit e mirëqenjen e popullit. Me më shumë se 3200 lloje të bimëve vaskulare dhe 756 specie vertebrorë dhe me rreth 30% të të gjithë florës europiane që zhvillohet në Shqipëri, me të drejtë mund ndjeme krenari për natyrën tonë. Por, ndërsa koncepti i biodiversitetit ka percaktim globale, ruajtja është thjesht një aktivitet lokal. Sa takon ruajtjes te gjithë duhet te ndehemi fajtor per humbjet ne biodiversitet. Shqipëria si një vend që synon të anëtarësohet në BE ka përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime konkrete për të mbrojtur Biodiversitetin e saj, duke qenë se humbja e këtij thesari me të gjithë ekosistemet, krijon efekte negative në ekonomi duke rrezikuar në një farë mënyre atë. Për të ndaluar humbjen e biodiversitetin në Shqipëri, duhet të ketë një sipërmarrje të përbashkët "Biodiversiteti është ekzistenca jonë, është ekzistenca juaj është me rëndësi përfshirja e komunitetit, në mënyrë që të ruhet kjo pasuri që në fund na bën të ndihemi kaq shumë krenarë." Përpjekjet për të mbrojtur tokat natyrore dhe ujërat tona duhet të jenë fokusi i interesit dhe veprimtarisë së të gjithëve dhe vlerësimi i statusit të ruajtjes së llojeve të veçanta është çelësi për të kuptuar gjendjen e përgjithshme të florës dhe faunës dhe vendosjen e prioriteteve për ruajtjen", Humbja e biodiversitetit si problem global, përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote. Ekspertet japin alarmin duke konkluduar: se nëse do te vazhdohet me këtë trend, humbja e biodiversitetit do te ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri ne 10 % te llojeve te njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonomine botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 %

e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike. Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shumë arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre: Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë, Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri, Mjedisin ndotet në tokë, ujë dhe ajër. Ky është një problem i madh i kohës sonë. Kështu përgjegjësit kryesor të ndotjes së ujërave të detit janë shkarkimet urbane, industriale, bujqësore të zonave më të zhvilluara, si edhe shkarkimet e naftës në zonat ku ajo nxirret. Edhe zonat e bregdeteve dhe ishujt rrezikohen nga ngrohja e klimës: shkrirja e një pjese të akullnajave çon në rritjen e nivelit të detit. Ndotja e ajrit dëmton jetën e njeriut, dëmton sytë, rrugët e frymëmarrjes. Sot në shumë vende ka agjenci që matin shkallën e ndotjes së ajrit dhe kur kjo është e lartë marrin masa si mbyllja e fabrikave, ndalojnë qarkullimin e makinave etj. Disa qytete të Shqipërisë, sidomos Tirana dhe Elbasani janë shumë të ndotur. Era e rëndë, thithja e ajrit të ndotur janë disa nga problemet e përditshme me të cilat përballen qytetet, ku trafiku i automjeteve, shkarkimet industriale dhe ngrohja e banesave janë të përqëndruara në zona të ngushta: kush banon në qytet e ndjen menjëherë problemin e ndotjes së mjedisit. Mbetjet urbane përmbajnë edhe produkte kimike që zbresin në thellësi dhe ndotin burimet e nëndheshme ujore. Në qytete, ndodhen gjithashtu edhe kantierët e ndërtimit, që shpesh derdhin nëpër lumenj sasi të mëdha materiali ndërtim. Zhvillimi i turizmit ka ndikime direkte në biodiversitet. Tashme vendi ynë është kthyer në një destinacion të njohur i orientuar tek ekoturizimi. Për fatkeq hapësira bregdetare ka qenë pre e shkatërrimeve që kanë rrjedhur nga përdorimi turistik i këtij rajoni. Pasojat më të mëdha të këtyre shkatërrimeve kanë të bëjnë me mbingarkesat ndërtimore të natyrës dhe të peizazhit. Të gjitha këto probleme konfliktuale që lindin midis turizmit dhe biodiversitetit në zonën bregdetare është shumë e rëndësishme të parandalohet në zonën malore dhe në peizazhet pyjore ekzistuese.

Gjëndja e disa specieve aromatiko-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

Nëpërmjet procesit të monitorimit është arritur vlerësimi i gjëndjes së disa specieve aromatiko-mjekësore me status “në rrezik zhdukje” si dhe vlerësimi i gjëndjes së Sherbelës në disa rajone jugore dhe veriore të vendit tone, duke siguruar të dhëna të plota, për bimët aromatiko-mjekësore. Me anë të këtij procesi monitorimi synohet:

- Njohja e gjëndjes aktuale të tyre,
- Përcaktimi i shkaqeve kryesore që kanë çuar në pakësimin dhe rrezikimin në zhdukje të tyre,
- Rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre,
- Përgatitja e një Data Bazë me të dhënat e këtij monitorimi dhe hartografimi i shpërndarjes së pikave monitoruese.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, VKM nr.47 date 29.01.2014 “Përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit për vitin 2018, pika 1.5, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka ndjekur monitorimin e treguesit “Biodiversiteti në pyje”: “Gjëndja e disa specieve aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje” për periudhën Janar - Dhjetor 2018. Llojet e përfshira në monitorim gjatë vitit 2018 janë:

1. Salepi (Orchis. Ssp),

2. Xhrokulli (*Calchicum automnale*),
3. Boronica (*Vaccinium nigrillus*),
4. Çaji i malit (*Sideritis roesseri*),
5. Sherbela *Salvia officinalis*,

Monitorimi është shtrirë në rrethet me sipërfaqe dhe potencial më të madh prodhues në shkallë vendi si: Berat, Skrapar, Gjirokastër, Permet, Korçë, Devoll, Pogradec, Kolonjë, Kukes, Tropoje, Shkoder, Puke, M. Madhe, Vlore, Sarandë, Delvinë. Për përcaktimin e arealit të përhapjes së këtyre llojeve janë shfrytëzuar informacionet e marra nga materialet arshivore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, planet e inventarizimit të bimëve aromatike-mjekësore si dhe ekspeditat në terren, për të përcaktuar egzistencën dhe përhapjen e llojeve të marra në studim në rajonet e përcaktura më lart. Ngritja e rrjetit të monitorimit është bërë në ato vende ku prezencë e këtyre llojeve ka pasur një shkallë mbulimi prej 15% të sipërfaqes monitoruese e cila për llojet Salep, Orchis. ssp dhe Xhrokull *Calchicum automnale* është ngritur në një sipërfaqe prej 25m² dhe për llojet Çaji i malit (*Sideritis roesseri*), Boronica (*Vaccinium nigrillus*) dhe Sherbelën (*Salvia officinalis*) sipërfaqja ka qënë 50 m.

Në sipërfaqet e ngritura është bërë kontrolli i numrit të egzemplareve, përshkrimi i gjëndjes vegetative, prodhimitaria e tyre, gjëndja fitosanitare si dhe karakteristikat e terrenit. Në të gjitha sipërfaqet e ngritura janë përcaktuar koordinatat e tyre nëpërmjet GPS, si dhe janë vendosur në qëndër të sipërfaqes shënja dalluese. Për përcaktimin e arealit të përhapjes së këtyre llojeve janë shfrytëzuar informacionet e marra nga materialet arshivore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, planet e inventarizimit të bimëve aromatike-mjekësore si dhe ekspeditat në terren. Gjithashtu është kryer ripërcaktimi dhe vlerësimi i Sipërfaqeve të Përhereshme Monitoruese (SPM) në terren.

Monitorimi i gjëndjes së disa specieve aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje është kryer në disa qarqe të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë si me poshtë:

- Salep, (*Orchis. Ssp*) dhe Xhrokull, (*Calchicum automnale*) në qarkun e Gjirokastrës (Këlcyrë dhe Përmet) në qarkun e Vlorës (Vlorë dhe Delvinë) dhe në qarkun Durrës (Durrës).
- Boronica (*Vaccinium nigrillus*) në qarkun Kukës (Kukës dhe Tropojë) dhe Dibër (Bulqizë).
- Caji i Malit në Korçë (Prespe) dhe Gjirokastër (Dropull).
- Sherbelës (*Salvia officinalis*) në qarkun Gjirokastër, Vlore (bashkitë; Gjirokastër, Vlore Dropull, Libohovë), Shkodër (bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe), Korçë (bashkia Kolonjë) dhe në qarkun Diber (bashkia Bulqize).

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarit e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune-Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar

“Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detarë/bregdetarë, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Sipas verifikimeve në portalin asig.gov.al, zona në vlerësim nuk bën pjesë në zonat me status të veçantë si zone e mbrojtur ose monument natyre nga MTM. Për verifikime me të detajuara dhe me të sakta subjekti, duhet të drejtohet Agjencise Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).


Monumentet Natyrore te Rrethit Elbasan (sipas VKM Nr. 303, date 10.05.2019)

QARKU ELBASAN			
Ahishtia e Rovjes	E ruan	Gramsh	E mirë
Bokërima e Garrunjës	E ruan	Peqin	E mirë
Burimet e Kërpicës	E ruan	Gramsh	E mirë
Burimi i Studnës	E ruan	Librazhd	E mirë
Dushkaja e Katër Lisave	E ruan	Gramsh	E mirë
Dushku i Bulçarit	E ruan	Gramsh	E mirë
Dushku i Kishës Gjinar	E ruan	Elbasan	E mirë
Dushku i Lleshanit	E ruan	Elbasan	E mirë
Frashëri i Madh Polis - Valë	E ruan	Elbasan	E mirë
Guri i Skenderbeut	Propozim për MN	Librazhd	E mirë
Guorra e Karajt(Guorra e Kosharrishtës)	E ruan	Librazhd	E mirë
Gurrat e Zeza Rrajce	Propozim për MN	Prrenjas	E mirë
Gurrët e Krushqëve	E ruan	Gramsh	E mirë
Habitati i Yllit Te Alpeve (Sopot)	Propozim për MN	Librazhd	E mirë
Hinka e Kosovës	E ruan	Belsh	E mirë
Kalaja e Rmoit Tunjes	Propozim për MN	Gramsh	E mirë
Kanioni i Holtës	E ruan	Gramsh	E mirë
Kanioni i Sinecit ose Saraselit	E ruan	Gramsh	E mirë
Karsti i Tervolit	E ruan	Gramsh	E mirë
Liqenet e Rrajcës	E ruan	Librazhd	E mirë
Liqenet e Shebenikut	E ruan	Librazhd	E mirë
Liqenet e Valamarës	E ruan	Maliq	E mirë
Liqeni i Degës	E ruan	Belsh	E mirë
Liqeni i Dushkut	E ruan	Gramsh	E mirë
Liqeni i Floqit	E ruan	Librazhd	E mirë
Liqeni i Seferanit	E ruan	Belsh	E mirë
Liqeni i Traganit	Propozim për MN	Librazhd	E mirë
Liqeni i varrit Te Plakes	E ruan	Librazhd	E mirë
Liqeni i Zi – Lenie	E ruan	Gramsh	E mirë
Lisat e Pashtreshit	E ruan	Elbasan	E mirë
Lisi Babaliut	E ruan	Peqin	E mirë
Mali (Shkëmbi) i Gradishtës	E ruan	Belsh	E mirë
Mani i Çupit	E ruan	Librazhd	E mirë
Mani i Zi i Joronishtit	E ruan	Elbasan	E mirë
Mështekna e Qarishtës	E ruan	Librazhd	E mirë
Mështekna e Zavalinës	E ruan	Elbasan	E mirë
Mocal i liqenit te Cakes	Propozim për MN	Prrenjas	E mirë
Moçalet e Grabovës	E ruan	Gramsh	E mirë
Pisha e Fushë Kuges Gjinar	E ruan	Elbasan	E mirë
Pishat në Teqen e Skënderbegasit (Pylli i Teqese se Skënderbegasit)	E ruan	Gramsh	E mirë
Pusi i Faqes së Madhe	E ruan	Prrenjas	E mirë
Pylli aluvial i Shushicës	E ruan	Elbasan	E mirë
Pylli i Stravajt	E ruan	Prrenjas	E mirë
Robulli i Valamarës	E ruan	Gramsh	E mirë
Rrapi i Bërzeshtës	E ruan	Librazhd	E mirë
Rrapi i Bezistanit	E ruan	Elbasan	E mirë
Rrapi i Gurrës së Labinotit	E ruan	Elbasan	E mirë
Rrapi i Haskos	E ruan	Peqin	E mirë
Rrapi i Taksimit	E ruan	Librazhd	E mirë
Rrapi i Uruçaj	E ruan	Peqin	E mirë
Rrapi i Vojvodës	E ruan	Elbasan	E mirë
Rrepet e Byshekut	E ruan	Elbasan	E mirë
Rrepet e Gurakuqit	E ruan	Librazhd	E mirë
Rrepet e Hotolishtit	E ruan	Librazhd	E mirë
Rrobulli i Grabovës	E ruan	Gramsh	E mirë
Rrobulli i Zeleshnjës	E ruan	Elbasan	E mirë
Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit	E ruan	Gramsh	E mirë
Shpella e Akullit (Shpella e malit të Letmit)	E ruan	Librazhd	E mirë
Shpella e Gracenit	E ruan	Elbasan	E mirë
Shpella e Gurit te Venjes	Propozim për MN	Prrenjas	E mirë
Shpella e Hasanit	E ruan	Librazhd	E mirë
Shpella e Kabashit	E ruan	Gramsh	E mirë
Shpella e Kusarit	Propozim për MN	Librazhd	E mirë

MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI.
ELBASAN, SHIRGIAN, MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T, PRANË LUMIT SHKUMBIN.

Shpella e Letanit(Letmit)	E ruan	Elbasan	E mirë
Shpella e Pishkashit	E ruan	Prrenjas	E mirë
Shpella e Plakes Gizaveshtit	Propozim për MN	Librazhd	E mirë
Shpella e Rines	Propozim për MN	Librazhd	E mirë
Shpella e Urakullit	Propozim për MN	Prrenjas	E mirë
Shpella Eremite e Koshorishtit	E ruan	Librazhd	E mirë
Shpella Shkëmbi i Bletës	E ruan	Librazhd	E mirë
Sofra e Skenderbeut	E ruan	Prrenjas	E mirë
Tarraca e Ballores (Qytezës)	E ruan	Gramsh	E mirë
Ujëvara e Sotirës	E ruan	Gramsh	E mirë
Ujvarat e Gostimes	Propozim për MN	Prrenjas	E mirë
Vidhi i Tabakut	E ruan	Peqin	E mirë
Vrima e Dardhës së Ariut	E ruan	Prrenjas	E mirë
Vrima e Stërqokave	E ruan	Prrenjas	E mirë

Zonat e Mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI.
ELBASAN, SHIRGJAN, MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T, PRANË LUMIT SHKUMBIN.

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT						VITI 2014-JANAR	
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3.000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.800.0
SHUMA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)						2	4,800.0
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2.630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1.380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8.000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2.000.0
10	II	Dibër	Mat	Zali Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9.424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29.216.9
		Tirane	Tirane	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Krujë	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22.230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, date 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
SHUMA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)						15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syr i Kaltër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0.0
SHUMA III Monument Natyre - Kategoria III (MN)							3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20.000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3.600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1.500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1.400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Khyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684, datë 02.11.2005	1	26.535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4.393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5.000.7
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Kortnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55.550.2
		Diber	Diber	Korab-Kortnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20.663.4
		Kukës	Kukës	Korab-Kortnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34.886.8
IV/1 Park Natyror Rajonal							
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKO nr. 16, date 03.04.2013	1	4.206.0
SHUMA IV Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)						23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27.323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19.738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23.027.0

MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI. ELBASAN, SHIRGJAN, MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T, PRANË LUMIT SHKUMBIN.

52	V	Tiranë, Diber, Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
SHUMA V		Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)				5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,200.0
SHUMA VI		Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)				4	18,245.0
TOTALI I ZM						16%	799

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
		Karaburun-Sazan		12,428.0
		Butrint		633.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave			
b	VKQ	Vendim i Keshillit të Qarkut			
c	MB	Ministria e Bujqesise			
d	ZM	Zone e Mbrojtur			

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, datë 22.08.1994	Nr. Site 781, dt. 29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr. Site 1290, dt. 28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liçeni Shkodres-Lumi Bunës	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr. Site 1598, dt. 2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce, Devoll	Liçeni I Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr. Site 2151, dt. 03.07.2013	15,118.6
TOTALI						%/Totali Republikës	3.42%
							98,180.6

DREJTORIA PYJEVE DHE BIODIVERSITETIT
SEKTORI I BIODIVERSITETIT DHE ZONAVE TË MBROJTURA
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.mjedisi.gov.al/


2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonën e zbatimit të këtij projekti ka burime ujore të rëndësishme të identifikuar. Keto burime ujore nuk ndodhen në brendësi të pronës së propozuar për zhvillim, projekti ruan një distancë nga keto burime ujore. Burimi ujor më i afërt dhe i rëndësishëm i kësaj zone është Lumi Shkumbin, shtrati i të cilit ndodhet rreth 100m në vijë ajrore, larg aktivitetit, në drejtimin perëndimor. Gjithashtu, në kufirin e pronës ku zhvillohet aktiviteti ndodhet një kanal ujites, i cili shërben për vaditjen e tokave bujqësore që ndodhen në këto zone. Burime ujore të tjera në zone, të cilat ndodhen pranë aktivitetit, nuk janë identifikuar.

Distancat qe ruan aktiviteti me burimet ujore te zones



Pamje e lumit Shkumbin



Me poshte paraqiten disa informacione te pergjithshme mbi cilesine e ujerave te rajonit, te shkeputura nga Raporti Vjetor i gjendjes ne mjedis te publikuar nga AKM.

Cilesia e lumenjeve

(Referuar Raportit te gjendjes se mjedisit per vitin 2018, Agjencia Kombetare e Mjedisit)

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.


BASENI I SHKUMBINIT

Monitorimi i ketij baseni realizohet ne 4 stacione kampionimi ne te gjithe gjatesine e tij, te cilat jane paraqitur ne forme tabelare si vijon. Vleresimi i cilesise se ujerave te basenit eshte kryer bazuar ne vlerat limite te parametrave te Direktives Kuader te Ujit.

Oksigjeni i tretur

Vlerat mesatare vjetore te ekspeditave te realizuara jane paraqitur ne forme grafike si vijon. Vlerat mesatare te permbajtjes se oksigjenit te tretur i klasifikojne keto ujera te Basenit te Shkumbinit ne Klasen I – Gjendje e larte pasi jane mbi normen > 7mgO/l.


OKSIGJENI I TRETUR



Nevoja Biokimike per oksigjen

Ky parameter eshte i rendesishem per vleresimin e cilesise se ujerave te lumenjve si nje tregues i shkalles së ndotjes. Tejkallim te vleres limite per kete parameter ka vetem per stacionin Sh4 – Ura Rrogzhine ku vlera mesatare e NBO5 eshte 8.8 mgO/l nga ekspedita ne ekspedite ka treguar rritje te vleres se NBO5 duke e klasifikuar kete stacion ne Klasen IV – Gjendje e varfer. Sic e veme re qarte edhe nga grafiku, impakti i shkarkimeve urbane afer zonave te banuara eshte i larte pasi ne origjinen e vet nga buron cilesia e ujerave eshte e mire.


NEVOJA BIKIMIKE PER OKSIGJEN



Permbajtja e amoniakut

Percaktimi i permbajtjes së amoniakut në kampione uji i percaktuar me metoden spektrometrike është parameter kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujerave sipas DKU. Grafiku paraqet të dhënat mesatare vjetore të ekspeditave të realizuara ku përqendrimi i amonjakut është nën normën e lejuar.

PERMBAJTJA E AMONJAKUT



Permbajtja e nitriteve

Sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, permbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar duke i vlerësuar në Klasën I – Gjendje të lartë të katër stacioneve të monitorimit të këtij baseni.


PERMBAJTJA E NITRITEVE



Permbajtja e nitrateve

Permbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje të lartë.


PERMBAJTJA E NITRITEVE



Permbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite të permbajtjes së orto – fosfateve.


PERMBAJTJA E FOSFORIT



Permbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare vjetore vleresojme se stacionet nuk e tejkalojne vleren e lejuar, permbajtja e te cilave varion nga 0.046 mg/l – 0.079 mg/l duke i klasifikuar ne Klasen I- Gjendjen e larte.

PERMBAJTJA E FOSFORIT TOTAL



Duke marre ne konsiderate te gjithe parametrat e DKU, vleresojme se ujerat e Basenit te Shkumbinit klasifikohen ne Klasen e IV – Gjendje e varfer per shkak te dy stacioneve te cilat paraqesin ndotje si Ura e Paprit dhe Ura Rrogzhine te cilat paraqesin vlera te larta te Nevojes Biokimike per Oksigjen.

LUMI I SHKUMBINIT

Të dhëna të përgjithëshme fiziko-gjeografike, klimatike dhe hidrologjike.

Pellgu i lumit Shkumbin, shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 2445 km², lartësia mesatare e pellgut rezulton 753,2 m, gjatësia e tij 181,4 km, pjerrësia mesatare e pellgut 300/00, dendësia e rrjetit hidrografik 1,9 km/km². Prurja mesatare shumëvjeçare e aluvioneve pezull është 187 kg/sek, kurse turbullira 3040 gr/m². Mineralizimi është 317 mg/l dhe përbëhet kryesisht nga bikarbonate. Prurja shumëvjeçare e Shkumbinit në derdhje është 61,5 m³/sek që i përgjigjet një moduli prej 25,2 m³/s/km². Koeficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun hidrografik është 0,59, moduli i rrjedhjes së aluvioneve pezull 2373 ton/km² në vit. Ushqimi sipërfaqësor i Shkumbinit përfaqëson 61 % të rrjedhes vjetore, ndërsa ai nëntokësor 39 %. Sipas rajonizimit klimatik të Shqipërisë, lugina e Shkumbinit, nga burimet ujore në drejtim të detit, përfshihet pjesërisht në nënzonën juglindore të Zonës mesdhetare malore, pjesërisht në nënzonën jugore të Zonës Mesdhetare paramalore, në nënzonën juglindore të Zonës mesdhetare kodrinore dhe së fundmi në nënzonën qëndrore të Zonës mesdhetare fushore, e cila zë dhe pjesën më të madhe të këtij rajoni. Rreshjet lëkundën nga 650-1700 mm dhe numri i ditëve me rreshje lëviz ndërmjet 85-120 ditëve. Temperatura mesatare vjetore lëviz nga 3-6 °C në 15-16 °C. Në pjesën e sipërme të luginës së Shkumbinit, pasuritë ujore janë të mëdha. Ato përfaqësohen nga vetë lumi i Shkumbinit, degët e shumta të tij dhe burimet karstike. Prurjet ujore

dallohen për pjerrësi të lartë të pellgjeve ujëmbledhëse dhe për mbulesë të pakët bimore. Në këto kushte ato dallohen për vlera të larta të prurjeve të lëngëta dhe të ngurta sidomos në stinën e pranverës. Burimet më të shumta takohen në krahun e majtë të luginës, në kontaktin tektonik të gëlqerorëve me molasat dhe magmatikët. Dallohen burimet e Spatharës, Babjes, Xhyrës, etj. Pyllëzimi në këtë pellg deri para viteve 90 ka përbërë rreth 44 % të sipërfaqes, ndërsa aktualisht kjo shifër duhet të jetë shumë më e ulët. Ulja e kësaj sipërfaqeje ndikon direkt në rritjen e vlerës së koeficientit të rrjedhës. Bimësia përbëhet kryesisht nga dushqet dhe më pak nga shkurret mesdhetare dhe ahishtet. Këto të fundit janë të përhapura në pjesët më të larta.

Ndërtimi gjeologjik i pellgut.

Formacionet gjeologjike që ndërtojnë pellgun e Shkumbinit, përbëhen, si nga llojet sedimentare ashtu edhe nga ato magmatike e matamorfike. Shkëmbinjtë sedimentarë përfaqësohen nga:

- Evaporitet e Permo-Triasit të Dumresë
- Depozitimet e Triasikut të Mesëm (gëlqerorë të kuq, silicorë të kuq, gëlqerorë pllakore me silicorë të facies pellagjike)
- Seria vullkanogjeno-sedimentare e Triasikut të Mesëm-Jurasikut të Poshtëm.
- Gëlqerorët shtresëtrashë të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm
- Gëlqerorët e kuqërremtë të Jurasikut të Mesëm
- Pakoja argjilite copëzore, pakoja konglobrekçioze ofiolitike dhe flishi gëlqeroro-mergelor i Jurasikut të Sipërm-Kretakut të Poshtëm
- Gëlqerorët, gëlqerorët konglomeratike, konglomeratet dhe rreshpet argjilo-silicore të Kretakut të Poshtëm
- Depozitimet e Kretakut të Poshtëm-Sipërm (ndërthurje flishoidale të gëlqeroreve, mergeleve, ranoreve dhe argjilave).
- Dolomitet dhe gëlqerorët dolomitikë të Kretakut të Sipërm
- Depozitimet flishore të Kretë-Paleogjenit (ndërthurje argjilash, alevrolitesh, mergelesh, gëlqerorësh mergelorë dhe ranorësh).
- Depozitimet e Paleogjenit (gëlqerorë, flishi ritëmhallë argjilo-alevrolitor me breza ranorësh dhe gëlqerorësh pelitike, pako copëzore ofiolitike, flishi ranoro-alevrito-argjilor, flishi ritëmmesëmtrashë ranoro-argjilor dhe flish ritëmhallë argjiloalevrolitor, flishi ranoro-konglomeratik)
- Depozitimet e Miocenit (ranorë, konglomerate, argjila, alevrolite, mergele gëlqerorë litotamnikë).
- Depozitimet e Pliocenit (konglomerate bazale, ndërthurje ranorësh e alevrolitesh të suites Helmësi, konglomerate dhe ranore të suites Rrogozhina).
- Depozitimet e shkrufta të Kuaternarit, si ato të Pleistocenit ashtu edhe ato të Holocenit.
- Këto të fundit përbëjnë aluvionet që ndërtojnë shtratin e Shkumbinit dhe terracën e parë të tij.
- Shkëmbinjtë magmatikë dhe metamorfikë përfaqësohen nga:
- Vullkanitet e Triasikut të Mesëm dhe të serisë vullkanogjeno-sedimentare (T2-J1) (diabaze e mikrodiabaze, variolite e mikrovariolite, porfirite diabazike, hialobazalte).
- Mesëm (harcburgite, dunite, lercolite dhe llojet e tyre plagjioklazike).
- Shkëmbinjtë metamorfikë (rreshpe amfibolitike, epidotike, kuarc-mikore dhe serpentinite).

STACIONI PROPTISHT

Tabela 13. Të dhënat e matjeve në stacionin e Proptishtit, lumi i Shkumbinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh6	
Data e kryerjes së matjeve	16 Prill, 2018	11 Shtator, 2018
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	3.5 m	3.9 m
Temperatura e ujit	10.2°C	15.6°C
Numri i nënseksioneve të ndara	7	8
Sasia e prurjeve	18.702	1.4
Rezja hidraulike R_p	0.7 m	
Moti	Para kësaj date koha ka qenë e mirë dhe pa rreshje. Dita e matjes është kohë me vranësira dhe rreshje të dobëta deri mesatare.	Prej mëse 10 ditësh moti ka qenë i mirë dhe pa rreshje.

STACIONI LABINOT

Tabela 14. Të dhënat e matjeve në stacionin e Labinotit, lumi i Shkumbinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh5	
Data e kryerjes së matjeve	17 Prill, 2018	12 Shtator, 2018
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7 m për degëzimin e djathtë dhe 6.7 m për të majtën	7.25 m
Temperatura e ujit	12.3°C	22.8°C
Numri i nënseksioneve të ndara	19	15
Sasia e prurjeve	123.924	11.867
Rezja hidraulike R_p	0.7 m	
Moti	Ka patur rreshje të dobëta deri mesatare në datën 16 Prill. Dita e matjes është kohë kryesisht e mirë me pak vranësira dhe pa rreshje.	Prej mëse 10 ditësh moti ka qenë i mirë dhe pa rreshje.

Tabela 15. Të dhënat e matjeve në stacionin e Labinotit, përroi i Gurrës.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh5	
Data e kryerjes së matjeve	17 Prill, 2018	12 Shtator, 2018
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7.1 m	7.2 m
Temperatura e ujit	15.3°C	22.8°C
Numri i nënseksioneve të ndara	6	15
Sasia e prurjeve	1.031	0.46
Rezja hidraulike R_p	0.14 m	
Moti	Ka patur rreshje të dobëta deri mesatare në datën 16 Prill. Dita e matjes është kohë kryesisht e mirë me pak vranësira dhe pa rreshje.	Prej mëse 10 ditësh moti ka qenë i mirë dhe pa rreshje.

STACIONI URA VJETËR, RROGOZHINË

Tabela 16. Të dhënat e matjeve në stacionin e Rrogozhinës, lumi i Shkumbinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh4	
Data e kryerjes së matjeve	18 Prill, 2018	10 Shtator, 2018
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	14.3	13.1 m
Temperatura e ujit	15°C	20.2°C
Numri i nënseksioneve të ndara	12	10
Sasia e prurjeve	103.378	20.801
Rezja hidraulike R_p	0.14 m	
Moti	Ka patur rreshje të dobëta deri mesatare në datën 16 Prill. Dita e matjes është kohë kryesisht e mirë me pak vranësira dhe pa rreshje.	Prej mëse dy javësh moti ka qenë i mirë dhe pa rreshje.

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes së mjedisit për vitin 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Aqencia Kombëtare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

3.1 INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerëzore dhe natyrore.

Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”.**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.**
- **Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”. I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008.**
- **Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.**
- **Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Vendim i KM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.**
- **Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”**
- **Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla të tjera”**
- **Vendim i KM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.**
- **Vendim i KM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror”.**
- **Vendim Nr. 417, date 25.06.2014 “Per miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”**
- **Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi të zhurmave”.**

Shenim:

Bazuar në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, ky aktivitet, përfshihet në listën e aktiviteteve që duhet të pajiset me leje mjedisore të tipit A, B ose C. *(Konkretisht pika 3.1.e “Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos”; pika 5.4.c. “Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme” dhe pika 5.10.b. “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”.*

3.2 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të subjektit "BLERIMI" Shpk, NIPT: J62903384G, me seli në Elbasan, Shirgjan, MJEKES, Fshati Mjekes, Zona Topcias, rruga Elbasan-Cerrik km 4-t, pranë lumit Shkumbin dhe me administrator Z. Behexhet Uruçi. Ky subjekt, ka paraqitur kërkesën për hartimin e procedurës së konsultimit me publikun pranë AKM-së dhe do të aplikojë pranë QKB-AKM për pajisjen me Leje Mjedisore të Tipit B për aktivitetin Magazinim dhe rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme (mbetjeve inerte) dhe prodhimi i produkteve prej betoni. Objekti i vleresimit të këtij raporti është aktiviteti i Magazinimit dhe rikuperimit të mbetjeve inerte të cilat dalin gjatë prishjes dhe ndërtimit të objekteve dhe rrugëve të cilat janë projekte në zhvillim të subjektit "BLERIMI" Shpk, si dhe prodhimi i produkteve prej betoni që përdoren si lende e parë për ndërtim (blloqe të ndryshme, tombino, kapake pusetash, bordure, shtylla të vogla, etj). Ky aktivitet ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Elbasan, Njesia Administrative Shirgjan, Mjekes, Fshati Mjekes, Zona Topcias, Rruga Elbasan – Cerrik Km 4-t, pranë lumit Shkumbin. Kapaciteti për punues të mbetjeve inerte është 10m³/ore, kapaciteti magazinues është 1000 - 2000m³ dhe kapaciteti për prodhimin e produkteve prej betoni është 8m³/ore. Aktiviteti ndodhet rreth 1.2km në vijë ajrore, larg Fshatit Mjekes dhe rreth 100m në vijë ajrore larg shtratit të lumit Shkumbin. Sipas shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, ky aktivitet klasifikohet në pikën 3.1.e "Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos"; pika 5.4.c. "Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme" dhe pika 5.10.b. "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme".

Ky raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, parashikon ndikimet në mjedis që mund të shkaktojë aktiviteti i magazinimit dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetjeve inerte) dhe prodhimit të produkteve prej betoni.

Ortofoto e vendodhjes së aktivitetit





MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI.
ELBASAN, SHIRGJAN, MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T, PRANË LUMIT SHKUMBIN.

FOTO TE AKTIVITETIT



MAGAZINIM DHE RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME (MBETJEVE INERTE) DHE PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ BETONI.
ELBASAN, SHIRGJAN, MJEKËS, FSHATI MJEKËS, ZONA TOPCIAS, RRUGA ELBASAN-CERRIK KM 4-T, PRANË LUMIT SHKUMBIN.



Mjetet e transportit





Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ky aktivitet nuk shoqerohet me shkarkime ne ujerat e ndotura. Gjate procesit te perpunimit te mbetjeve inerte nuk perdoret uje, nuk kemi larje te mbetjeve inerte, ndersa gjate procesit te prodhimit te betonit perdoret uje, kjo ne sasi te paket, rreth 1-2m³/dite konsum uji. Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e larjes se betonieres, larjes ose shplarjes se kantierit nga rreshjet atmosferike. Keto ujera kalojne ne nje vaske dekantuese dhe me pas riperdoren serish per procesin e prodhimit te produkteve prej betoni. Nuk kemi shkarkime te ujerave te ndotura ne mjedisin e zones. Ne sheshin e aktivitetit, nuk magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk ka ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore nga kimikate te rrezikshme.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare per prodhimin e betonit, nga nenproduktet e depozituara, nga procesi i thyerjes se mbetjeve inerte (pasi eshte nje proces qe ndodh ne te thate). Shkarkimet spontane, nuk vleresohen me ndikime te rendesishme ne mjedis dhe ne komunitetin e zones. Pervец pluhurit te ngritur ne ajer nga era dhe gjate proceseve te punes ne kete ambjent, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Per eleminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithë kohes.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga proceset e punes qe zhvillohen ne kete kantier. Mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk shkaktohen vibrime.

Ndikimi ne toke

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke, por zenia e nje siperfaqe toke nga instalimi dhe depozitimi i materialeve, eshte tashme nje fakt dhe nuk ndryshon gje vleresimi ne kete faze. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.

Ndikimi ne Biodiversitet

Sipas verifikimeve ne portalin asig.gov.al, kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem. Te gjitha mbetjet inerte futen ne makinerine e thyerjes nga ku behet perpunimi fizik i tyre dhe ndarja e tyre ne granulometri te ndryshme dhe ne fund duke u perdorur si materiale te dores se dyte, per mbushje dhe sistemime te brendshme te objekteve, per mbushje te rrugeve dytesore (rruge fshat, rruge malore, etj).

4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ky aktivitet nuk shoqerohet me shkarkime ne ujerat e ndotura. Gjate procesit te perpunimit te mbetjeve inerte nuk perdoret uje, nuk kemi larje te mbetjeve inerte, ndersa gjate procesit te prodhimit te betonit perdoret uje, kjo ne sasi te paket, rreth 1-2m³/dite konsum uji. Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e larjes se betonieres, larjes ose shplarjes se kantierit nga rreshjet atmosferike. Keto ujera kalojne ne nje vaske dekantuese dhe me pas riperdoren serish per procesin e prodhimit te produkteve prej betoni. Nuk kemi shkarkime te ujerave te ndotura ne mjedisin e zones. Ne sheshin e aktivitetit, nuk magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk ka ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore nga kimikate te rrezikshme.

Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare per prodhimin e betonit, nga nenproduktet e depozituara, nga procesi i thyerjes se mbetjeve inerte (pasi eshte nje proces qe ndodh ne te thate). Shkarkimet spontane, nuk vleresohen me ndikime te rendesishme ne mjedis dhe ne komunitetin e zones. Peverc pluhurit te ngritur ne ajer nga era dhe gjate proceseve te punes ne kete ambjent, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Per eliminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithë kohes.

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga proceset e punes qe zhvillohen ne kete kantier. Mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk shkaktohen vibrime.

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem. Te gjitha mbetjet inerte futen ne makinerine e thyerjes nga ku behet perpunimi fizik i tyre dhe ndarja e tyre ne granulometri te ndryshme dhe ne fund duke u perdorur si materiale te dores se dyte, per mbushje dhe sistemime te brendshme te objekteve, per mbushje te rrugeve dytesore (rruge fshat, rruge malore, etj).

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi zgjat per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti prodhues, pra fare pak ore ne dite dhe sasi te vogla prodhimi e shkarkimesh. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne nje vit. Ky impiant nuk funksionon cdo dite.

6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance fare te ngushte, me dhjetera metra, ose deri ne 100m, kjo persa i perkete ndikimit te zhurmes dhe ndikimit ne ajer. Persa i perkete ujerave qe dalin nga aktiviteti nuk kane ndotje kimike, por vetem turbulliren me lenden e fraksioneve te imeta te materialeve inerte. Keto

ujera kalojne ne nje vaske dekantuese dhe me pas riperdoren serish per procesin e prodhimit te produkteve prej betoni. Nuk shkarkohen substanca ose elemente te demshem per mjedisin, si ne ate uJOR, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Nuk ka procese me perdorimin e substancave te demshme. Per parandalimin e ketyre efekteve, subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet teknike. Per eliminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithë kohes.

7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedi i ketij aktiviteti eshte me funksion si Magazinim dhe rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme, mbetje inerte te cilat krijohen gjate prishjes apo rikonstruksionit te objekteve dhe rrugeve, ne varesi te projekteve te subjektit dhe prodhimi i produkteve prej betoni. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, do te merret ne konsiderate mundesia e rehabilitimit te plote te siperfaqeve dhe kthimin e peizazhit ne gjendjen e mepareshme. Per kete subjekti duhet te hartoje nje plan mbyllje te aktivitetit, qe duke u nisur nga strukturat e perkohshme, nuk paraqitet me kosto te larta.


8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme paraqesim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per mbarefunksionimin e ketij aktiviteti. Ndikimet negative ne mjedis gjate zhvillimit te ketij aktiviteti jane ne nivele te konsiderueshme. Keshtu qe gjykojme se jane teper te nevojshme qe ne vija te pergjithshme te kihen parasysh dhe te ndermerren disa masa nga kompania. Keto masa renditen ne listen e rekomandimeve te meposhteme:

- Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike, nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese ne mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambjentin dhe mund te jene burim aksidenti e shkaktar te zjarreve te pa deshuruara e me tej mund te shkaktoje edhe shperthime.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme.
- Mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten perkatese.
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).
- Te rehabilitohet siperfaqja perreth objektit, duke u gjelberuar dhe duke krijuar nje efekt ndihmes ne reduktimin e zhurmes dhe te pluhurit.
- Te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithë kohes per eliminimin e pluhurave.
- Te mirembahet sheshi i depozitimit, duke mos lejuar erozionin dhe shplarjen e materialit per ne burimin uJOR prites.
- Te respektohen normat ne fuqi te shkarkimeve ne mjedis sipas VKM Nr. 177, date 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- Te mos punohet gjate oreve te vona, pasi prane ka objekte banimi, te cilat do te ndikoheshin nga niveli i zhurmes.

9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TRËTITISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-2068-09-2016
NUJS/NIPT: L6Z113034E

LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

E vlefshme për subjektin: "BLERIMI" SHPK
i Magazinit dhe rikuperim i mbetjeve të
dhe problemim i prodhuesve prej betonit i
F. Mjedis, Zona Topçiu, Rr. Elbasan - Ceçuli Km.12.

Fëmbedhjetë Jeteknikë

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike


Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Green Solution
TIRANA
(Mbetjeve inerte)
Elbasan, Shqipëri, Mjedis
Nënshkrimi i sportelit:
Pronë: Laert Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11693 Prot.

Tiranë, më 12.12 2014

Nr. identifikues 262

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

Tëmbledhje e teknike

*Erlefshme për subjektin "BERIMI" Shpk.
Magazinin dhe rikuperimin e mbetjeve jo të
meletshme (mbetjeve meletshme) dhe prodhimi i
prodhimeve prej betoni, me vendodhje në
Elbasan, Shqipëri, Mylis, Fshati Mylis, Zona Topcis,
Pr-Elbasan-Cendri km 4+1, pranë lumit Shkumbin.*

MINISTRI

Lefter KOKA

